

VENDIM
Nr.266, datë 30.11.2011

PËR ZGJERIM ZONE LICENCIMI PËR TELEVISIONIN PRIVAT VENDOR
“UTV EDUCATION”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “UTV EDUCATION” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr.355, datë 29.8.2005 dhe rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “UTV Education” sh.p.k., për zgjerimin e zonës së licencimit dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të shoqërisë “UTV Education” sh.p.k., për televisionin privat vendor “UTV Education”, sipas licencës nr.009 TVL, në qarqet Elbasan-Korçë.
 2. Karakteristikat teknike janë pjesë përbërëse e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
 3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati